



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
Nezavisna Komisija za Rudnike i Minerale
Independent Commission for Mines and Minerals



Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, Njësia për Burime Njerëzore, në pajtim me Ligjin Nr. 06/L – 114 për Zyrtarët Publik, dhe në pajtim me Ligjin Nr. 05/L – 031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nxjerr këtë :

NJOFTIM

Njësia e Burimeve Njerëzore me datë 20.10.2022 në pajtim me Ligjin Nr. 06/L – 114 për Zyrtarët Publik ka përfunduar procedurën e verifikimit paraprak për pozitën Drejtor i Përgjithshëm-1 në KPMM, në bazë të autorizimeve të dhëna me paragrafin 6 të nenit 40 dhe legjislacionin tjetër përkatës për zyrtarët publikë. Më vonë Njësia e Burimeve Njerëzore ka konstatuar se është bërë një gabim në vlerësimin e kriterëve të konkursit përkatësisht janë përjashtuar të gjithë kandidatët të cilët nuk kanë sjellë dokumentin për aftësinë për të vepruar dhe dokumentin për gjendjen shëndetësore të cilat fillimisht nuk janë kërkesë e drejtpërdrejtë e konkursit. Pas një vlerësimi të gjithë situatës faktike dhe ligjore kemi ardhë në përfundim se një situatë e tillë sjellë në paligjshmëri në kuptim të paragrafit 1.6 të nenit 52 të Ligjit Nr. 05/L - 031 për Procedurat e Përgjithshme Administrative ku me veprimet e ndërmarra i është cenuar e drejta e kandidatëve për të vazhduar fazat e mëtejshme të procedurës së rekrutimit të cilët nuk kanë dorëzuar dokumentin e aftësisë për të vepruar dhe dokumentin për gjendjen shëndetësore e të cilat nuk kanë qenë kërkesë e obligueshme sipas konkursit të shpallur me 01.09.2022 dhe nuk janë njoftuar në mënyrë të saktë se nevojiten dokumentet e tilla.

Duke u bazuar në paragrafin 1 të nenit 53 të Ligjit Nr. 05/L – 031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Njësia e Burimeve Njerëzore si organ kompetent për fazën e verifikimit paraprak dhe duke vlerësuar se e gjithë procedura deri në këtë fazë është e ligjshme dhe e rregullt, vendosi që të bëjë shfuqizimin e vendimeve për të gjithë kandidatët që kanë aplikuar për pozitën Drejtor i Përgjithshëm-1 në KPMM, të cilët janë përjashtuar me arsyen se nuk posedojnë dokumentit e aftësisë për të vepruar dhe dokumentin e gjendjes shëndetësore dhe të njëjtit të vlerësohen pa u marr parasysh dokumentet e lartcekura.

Prishtinë, 09.11.2022



Nënshkrimi

Samir Preteni – Kryesues i Departamentit të Administratës

KOPJË	
KOMISIONI I PAVARUR PËR MINIERA DHE MINERALE	
NEZAVISNA KOMISIJA ZA RUDNIKE I MINERALE	
INDEPENDENT COMMISSION FOR MINES AND MINERALS	
PRISHTINE	
DATE	
DEPISHE	NR. 3894
DEPISHE	NR. 3894
DEPISHE	NR. 3894
NUMRI I FALCIT	09.11.2022
NUMRI I FALCIT	09.11.2022
NR. OF PAGES	09.11.2022
PRINTED AT	

Rr. Armend Daci Nr. 1
Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 (38) 240 252
Fax: +383 (38) 245 844
E-mail: ICMM@kosovo-mining.org
Web: www.kosovo-mining.org

Kuvendi i Kosovës
Skupština Kosova
Assembly of Kosovo